



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:013404  
Datë: 15.08.2024  
Numri i dokumentit: 06053344

**AC-I-23-0337**

**Në ankesën e**

***Paditësi***

**Sh H**, Podujevë, i përfaqësuar nga avokati B I, Prishtinë.

**Kundër**

***E paditura/Ankuesja***

**N.SH "FAN "Zahir Pajaziti", Podujevë (në Likuidim)** e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Hasim Sogojeva gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6421 të datës 22 maj 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 15 gusht 2024, lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-6421 i datës 22 maj 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike:**

Me 02 tetor 2014, ankuesi pranë DHPGJS, parashtroj një ankesë për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit ( AL) PRN046-0453 të datë 01 shtator 2014, me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e tre (3) pagave të papaguara, në shumë prej 660.00 euro, ndaj NSH FAN "Zahir Pajaziti" (në likuidim), me arsyetimin se ishin parashkruara sipas nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi pohoi se me anë të njoftimit së Agjencisë, datë 24 mars 2006, i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe po me të njëjtin njoftim është informuar mbi të drejtën mbi realizimin e së drejtës në paga të papaguara. Paditësi konsideron se kërkesa kreditore nuk është e parashkruar, fillimisht duke u mbështetur në nenin 36 por edhe nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP. Ankuesi, gjithashtu pohon se i është përmbajtur Njoftimit të Agjencisë dhe udhëzimeve të këtij njoftimi, se e drejta e tij mbi pagat e mbetura borxh do të trajtohen në procedurë të likuidimit, të NSH. Nga gjitha këto arsye, paditësi konsideron se janë plotësuar edhe kushte ligjore të nenin 387 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve- LMD. Tutje pohon, se Vendimi i AL është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për AKP. Ankesës ja ka bashkangjitur këto dokumente: kopjen e autorizimit për përfaqësim, Kopjen e vendimit të AL-së, Kopjen e librezës së punës, Kopjen e Njoftimit, datë 24 mars 2006, leshura nga Agjencia mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, drejtuar paditësit ( në tekstin NJOFTIMI), si dhe kopjen e listës se pagave individuale të mbetura borxh e përpiluar nga NSH-ja.

Me 26 maj 2020, përfaqësuesi i paditësit parashtroj një parashtresë për rregullimin dhe plotësimin e kërkesës për rishikim apo, siç emërtohet, padisë.

Edhe me anë të kësaj parashtrese, mbetet në tërësi si pranë kërkesës për rishikim-padisë, dhe pohimeve të saj. Ankuesi i referohet, NJOFTIMIT të AKP, kundërshtimeve lidhur me aplikimin e dispozitave ligjore të Ligjit për punën e bashkuar-LPB, dhe të drejtës së ankuesit mbi kompensimin duke u bazuar në dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe Ligjit të punës në Kosovë. U kërkuan edhe shpenzimet e përfaqësimit, në shumë të përgjithshme prej 312.00 (tre një dy) Euro, dhe atë në emër të kërkesës, shqyrtimit të shkresave, ankesës dhe përgjigjes, si dhe kompensimi i taksave gjyqësore në shumë prej 20.00 (dy zero) Euro. Me anë të kësaj parashtrese tani u kërkua kompensimin i pagave në shumë prej 660.00 Euro si dhe kamatën prej 10 %.

Me 15 mars 2023 AKP e ka kundërshtuar ankesën si të pabazuar. Sipas AKP AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e ankuesit ka vendosur në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se ankuesi nuk ka ofruar argumente ligjore, në favor të ankesës së tij, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP gjithashtu pohon se ankesa e ankuesit, e parashtruar pranë DHPGJS, është e parashtruar pas kalimit të afatit ligjore. AKP përfundimisht pohon se kërkesa kreditore e ankuesit konsiderohet e parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për AKP, pasi që nuk është zhvilluar ndonjë procedurë në afat prej 3 (tre) vitesh. Nga gjitha arsyet propozoj që ankesa e ankuesit të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet. Përgjigjes i ka bashkangjitur: Kopjen e Vendimit të AL, dhe Kopjen e Vendimit për emërimin e anëtarëve të AL.

Me 30 mars 2023 përfaqësuesi si paditësit parashtror një përgjigje ndaj mbrojtje se AKP-së dhe theksoj se i kundërshton pohimet e AKP dhe mbeti në tersi si pranë kërkesës për rishikim respektivisht parashtrësës për rregullimin dhe plotësimin e kërkesës për rishikim. Përgjigjes i janë bashkangjitur: Kopja e NJOFTIMIT, dhe Kopja e listë së pagës për ankuesin.

Me 22 maj 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ka marrë Aktgjykimin C-IV-14-6421, me të cilin Kërkesa për rishikim të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit e ka aprovuar si të bazuar, ka shfuqizuar Aktvendimin e Autoritetit të likuidimit PRN046-0453 të datë 01 shtator 2014 dhe ka Obliguar Autoritetin e Likuidimit - AKP që paditësit, në emër të kompensimit të tre (3) pagave të papaguara, ti paguhet shuma prej 660.00 Euro dhe në emër të interesit ligjor prej 10 %, t'i paguaj shumën prej 66.0 Euro. Në emër të përpilimit të kërkesës për rishikim – ankesës dhe përgjigjes ndaj përgjigjes së AKP, të ja paguaj përfaqësuesit të paditësit shumën prej 208.00 Euro, gjersa pjesa tjetër e mbetur prej 104.00 Euro në emër të kërkesës kreditore dhe shqyrtimit të shkresave si dhe kërkesa mbi kompensimin e taksave gjyqësore në shumë prej 20.00 Euro refuzohet. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësi ka arritur që të dëshmojë se ka qenë punëtor i NSH në kohën privatizimit të tij dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/ veprimit të AKP. Shkalla e I-rë ka konstatuar se lista e pagave individuale dhe njoftimi të parashtruara nga paditësi si dhe lista e pagave argumentojnë faktin se: paditësit i

janë mbetur pagat e pa paguara dhe se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i NSH-së gjer me datën e privatizimit, respektivisht 24 mars 2006, kohe kur edhe u privatizua NSH-ja.

AKP-ja, asnjëherë si me anë të Vendimit të AL ashtu edhe përgjigjen e saj, nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e paditësit, respektivisht nuk ka argumentuar të kundërtën me çka paditësit do ti mohojë e drejta në kompensimin e pagave.

Gjykata me rastin e aprovimit të shumës, është bazuar në Listën e Pagave nga e cila shihet e mbetur e pa paguar. Paditësi ka arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të Shtojcës së Ligjit për AKP. Ndërsa me rastin e vendosjes lidhur me kamate ligjore, në pajtim me nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP, ku thuhet si në Vijim:” të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund te përfshijnë kamate në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës se Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamate të mos tejkalojë 10% ( dhjetë për qind) të shumës themelore”, andaj edhe vendosi t’ia njeh shumën prej 66.00 euro. Gjithashtu Shkalla e I-rë në arsyetim ka theksuar se paditësi ka arritur ta dëshmojë me anë të Njoftimit ashtu siç qëndron edhe në tekstin e saj, se ka punuar pranë NSH gjer me datën 24 mars 2006 andaj pavarësisht pohimeve të AKP, paditësi ka dëshmuar se ishte punëtor i NSH-së gjer me datën e fillimit të privatizimit dhe se marrëdhënia e punës i është ndërprerë me veprimin e agjencisë ( neni 40 i Shtojcës së Ligjit për AKP). Shkalla e I-rë në arsyetim të vendimit ka arsyetuar se sipas dispozitave të lartë cekuar AKP me vet faktin e njoftimit me shkrim ndaj paditësit për obligime nga marrëdhënia e punës e ka ndërprerë parashkrimin.

Shkalla e I-re ka konstatuar se rregullat për parashkrim nuk mund te zbatohen sepse veprimi i vetëm i paditësit në rastin konkret ishte kërkesa drejtuar komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj te veçante e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtojca e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit. Po ashtu Shkalla e I-rë ka konstatuar se asnjë punëtor apo kreditor potencial nuk mund ti realizojë të drejtat e tyre kreditore ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo e parashtruesit nuk ka iniciuar rast ligjor, konsiderohet i pa pranueshëm.

Me 07 qershor 2023, e paditura e dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-6421 të datës 22 maj 2023, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0453 i datës 01 shtator 2014. Për më tepër në ankesë e paditura ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar-afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja ka pretenduar se kërkesa për 3 paga të fundit të papaguara është dashtë të paraqitet brenda tre viteve nga viti 2006, prej kur paditësi nuk ka përfutuara të ardhura personale, që nënkupton se kërkesa është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me 30 korrik 2024, paditësi e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Me të cilën ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës të vërtetohet Aktgjykimi i atakuar dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës. Në këtë parashtresë paditësi i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të AKP-së dhe ka pohuar se AKP-ja në ankesën e saj vetëm i ka përsëritur pohimet dhe argumentet e dhëna e nuk ka paraqitur asnjë provë të re ose as një argument të ri ligjor. Tutje paditësi pretendon se Gjykata e Shkallës së I-rë në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike pas administrimit të provave të sjellura nga paditësi, andaj me të drejtë Gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia për kompensimin në emër të 3 pagave të fundit të pa paguara shumë prej 660.00 euro dhe interesin ligjor prej 66.00 euro të cilat do të paguhen në procedurën e likuidimit sipas prioriteteve të kërkesave dhe interesave, sipas Nenit 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së(Ligji nr.04/L-034) dhe se pretendime të palës ankuese/ të

paditurës se gjykata është bazuar thjeshtë në supozime nuk i ka përmbushur aspak detyrimin e s shprehur në nenin 54 të Ligjit Nr.06/L086 për Dhomën e Posaçme mbi nevojën e analizës së provave dhe parashtrësive të prezantuara gjatë procedurës si dhe ka injoruar bazën kryesore të refuzimit si dhe pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë i bënë pretendime të pa bazuara dhe kështu ankesa e saj duhet të refuzohet si e pa bazuar. Nga këto arsye paditësi ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e AKP –së refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se Autoriteti i Likuidimit pran AKP-së e ka refuzuar si të pa vlefshme, kërkesën e paditësit për kompensimin e 3 pagave të fundit të pa paguara ne shume prej 660.00 euro, me arsyetimin se kërkesa e paditësit për këto 3 paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, e ka aprovuar ankesën e paditësit si bazuar dhe e ka ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0453 të datës 01 shtator 2014, dhe e ka obliguar AKP-në ti paguaj paditësit 3 pagat e papaguara në shumë prej 660.00 euro, në emër te interesit ligjor prej 10% ti paguaj shumën prej 66.00 euro, si dhe t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 208.00 euro.

Kolegji i Apelit duke u bazuar në provat që ekzistojnë në dosje të Shkallës së I-rë, nuk mund të pajtohet me konstatimin e gabuar të Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për këto 3 paga është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në procedurën pranë Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, ai ka sjellë Njoftimin zyrtar të ish AKM-së me të cilën vërtetohet se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 24 mars 2006. Ky njoftim e ka ndërprerë afatin e parashkrimit. Në bazë të këtij njoftimi, atë ditë është shitur Ndërmarrja në bazë të vendimit të Bordit të ish AKM-së, dhe marrëdhënia e punës paditësit i është ndërprerë menjëherë. Në këtë njoftim thuhej "shumat e pagave që u janë mbetur borxh sipas Kontratës suaj të punësimit do të mbesin në përgjegjësin e punëdhënësit, ndërsa kërkesat do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura".

Paditësi duke u bazuar në këtë njoftim ka pritur të filloj procedura e likuidimit ndaj NSH-së, dhe pastaj të paraqesë kërkesën për paga. Paditësi në afatin ligjor ka paraqitur kërkesën e tij tek Autoriteti i Likuidimit me datë 3 Tetor 2013. Andaj nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi ne Shkallen e parë si prova kishte paraqitur: Kopjen e librezës së punës, Kopjen e Njoftimit, datë 24 mars 2006, leshura nga Agjencia mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, drejtuar paditësit, kopjen e listës se pagave individuale të mbetura borxh e përpiluar nga NSH-ja si dhe Librezën e punës.

Prandaj duke u bazuar në këto prova, Kolegji i Apelit vjen në përfundim se paditësi ka të drejtë ti paguhet kompensimi për 3 pagat e pa paguara në shumë prej 660.00 euro, në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, për intresin ligjor prej 10%, ti paguhet shuma prej 66.00 euro, si dhe për shpenzimet e procedurës ti njihet shuma prej 208.00 euro.

Andaj nga se u tha më lartë, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar, nuk ka mundësi të ndryshohet, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 27 qershor 2023 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 15 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_